

BEQIR META

NACIONALIZMI DHE MINORITETET*

Për të kuptuar më mirë trajtimin e minoriteteve në Shqipëri është e nevojshme të kuptohen edhe të njihen karakteristikat dhe veçoritë e nacionalizmit shqiptar sepse nacionalizmi ka një ndikim të madh në qëndrimet dhe në politikat ndaj minoriteteve.

Nacionalizmi perëndimor, thotë profesori Hans Kohn, bazohet në realitetin politiko-shoqëror, ndërsa nacionalizmi lindor në mite dhe ëndrra¹. Ky ndryshim thelbësor është shkaku kryesor i qëndrimeve thuajse të kundërta i të dy nacionalizmave kundrejt minoriteteve.

Në botën perëndimore, në Angli, Francë, Hollandë, Zvicër, ShBA e në Dominionet Britanike, lindja e nacionalizmit ishte kryesisht një shfaqje politike. Ajo u pasua nga formimi i shtetit kombëtar të së ardhmes ose siç ndodhi në SHBA, koincidoi me të. Në Evropën Qendrore e Lindore dhe në Azi, nacionalizmi jo vetëm që lindi më vonë, por gjithashtu ai përgjithësisht u shfaq në momentet historike kur këto vende ishin në një shkallë më të prapambetur të zhvillimit social e politik. Kufijtë e një shteti ekzistues dhe të një kombi në krijim përputheshin shumë pak. Kështu nacionalizmi u rrit në proteste dhe në konflikt me shtetin ekzistues. Ky konflikt nuk kishte të bënte me objektivin për ta transformuar atë në një shtet të popullit, por për të ridimensionuar kufijtë politikë në përputhje me kriteret etnike².

Ndryshe nga Evropa Perëndimore, ku para shek. XIX ishte arritur një homogjenitet nacional relativ, Evropa Lindore dhe Qendrore i ka ruajtur diferencat deri në ditët e sotme. Arsytet janë të shumta. Ndërsa migrimet kishin pushuar në Perëndim në një periudhë të hershme, në Lindje ato vazhduan gjatë gjithë kohës, shpesh në formën e kolonizimit të paramenduar. Gjithashtu kufijtë e shteteve lindore mbetën fluidë dhe çdo pushtim territori solli masa njerëzish, të cilët kishin ndryshime nga pikëpamja nacionale e kulturore me grupin

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore mbi nacionalizmin në trojet shqiptare, organizuar nga shoqata “Vatra e Arbrit”, Shkup, 26 korrik 2009.

¹ Peter F. Sugar, Ivo J.Lederer, *Nationalism in Eastern Europe*, Washington: 1969, f.10.

² Hans Kohn, *The Idea of Nationalism: A study in its Origins and Background*, 2d ed. New York: “Macmillan”, 1961, f.329.

dominues, që kishte ndërtuar shtetin. Kjo do të thotë se problemi i minoriteteve në këtë rajon ishte më i mprehtë dhe më gjurmëlënës. Për më tepër, influenca e Romës, veçanërisht e Kishës Katolike Romake, kishte vepruar në Mesjetë duke i rrafshuar dallimet në Perëndim. Ndërsa në Lindje, kisha vetëm se i thelloi ndryshimet, sepse ajo u takua dhe u përplas me kulturën bizantine dhe me kishën greke. Efekti unifikues i pushtetit mbretëror ishte i fuqishëm në Perëndim, pjesërisht për arsye se në fillim të kohëve moderne ndërgjegjja kulturore e gjuhësore e masave ishte ende në një shkallë rudimentare, kështu që nuk pati një rezistencë efektive ndaj procesit të asimilimit. Ndërsa në Lindje, partikularizmi feudal e lokal nuk iu nënshtrua centralizmit politik e administrativ, deri në shekullin e XIX, kur nacionalizmi po bëhej një forcë e ndërgjegjshme. Kjo ko incidencë do ta bënte shumë të mprehtë problemin e minoriteteve.

Në veprat shkencore që trajtojnë nacionalizmin në Evropën Lindore i është kushtuar vëmendje e madhe problemit të kombeve historikë e të kombeve johistorikë. Kjo ndarje veçon ato popuj që kanë qenë zot të fatit të tyre në kohët moderne nga ata që nuk kanë qenë ose pavarësia e tyre ishte eliminuar para kaq shumë shekujsh, saqë, ata efektivisht e kishin humbur kujtimin e pavarësisë. Kështu, ka autorë, që mendojnë se disa kombe nuk kanë histori ose të paktën ata nuk kanë luajtur rol në histori, thjesht për arsyen se ata nuk kanë qenë forcë dominuese nga pikëpamja politike, ngaqë ata nuk kanë krijuar, mbajtur ose drejtuar shtete. Por ky përcaktim është i vlefshëm vetëm për të gjykuar në pikëpamje të supremacisë politike. Ai përmban shumë kufizime, të cilat e bëjnë shumë të vështirë për të vlerësuar shfaqjen e nacionalizmit modern në Evropën Lindore, si dhe çështjen e minoriteteve.

Çdo grup social, i cili ka ruajtur zakonet e veta, kujtimet, traditat, folklorin, institucionet fetare, gjuhën, historinë (edhe kur ajo është shkruar nga pjesëtarë të një grupi tjetër), madje edhe nëse ka ruajtur kujtimet e vakta, korrekte apo false të së shkuarës ose edhe aftësinë për të rindërtuar të kaluarën, ka një histori e rrjedhimisht edhe një identitet të veçantë. Këto kritere të kombinuara duhen përdorur për të analizuar karakterin dhe natyrën e minoriteteve.

George Weill ka nënvizuar se të drejtat njerëzore dhe të drejtat historike janë dy qasjet kryesore të nacionalizmit. E para, është pjesë racionale dhe merret me problemet e së tashmes. Kjo është edhe qasja perëndimore. E dyta, që ka qenë mbisunduese në Gjermani dhe në Evropën Lindore është romantike dhe synon ringjalljen e “kohëve të shkuara të mrekullueshme”³.

Ka shumë të dhëna të qarta se nacionalizmi shqiptar në fundin e shek. XIX dhe gjate shek. XX ka pasur si bazë më së shumti qasjen e parë, gjë që e

³ George Weill, *L'Europe du XIX^e siècle et l'idée de nationalité*, Paris: 1938, f.11-13.

bën shumë të ndryshëm nga nacionalizmat e tjerë ballkanikë e lindorë dhe që është manifestuar më së miri në qëndrimin e tij ndaj minoriteteve.

Është e kuptueshme dhe natyrisht jo ndonjë gjë specifike për rajonin, që popujt e Evropës Lindore janë mosbesues ndaj njëri-tjetrit. Mendimi bardhë e zi nuk është i kufizuar vetëm në këto vende. Ksenofobia e thelloi dhe e avancoi zhvillimin e nacionalizmit në Evropën Lindore. “Grekët shihnin barbarët tek çdo banor tjetër i Ballkanit, ndërsa popujt e tjerë të Ballkanit i urrenin ata sepse i konsideronin dominues, tregtarë dhe lakenj të otomanëve”⁴.

Nacionalizmi burokratik ishte i zhvilluar në Greqi e në Turqi. Përçarja e grekëve ishte një problem serioz, i cili e bënte veprimin unik të vështirë, madje edhe pasi Greqia fitoi pavarësinë. Në këto rrethana vetëm qeveria dhe burokracia mund të thoshin fjalën e tyre që të dëgjohej fort në të gjithë vendin. Nacionalizmi irredentist ofronte zgjidhje për të gjitha këto nevoja dhe ai u shndërrua në një armë kryesore të propagandës brenda e jashtë vendit, e cila ishte në duart e qeverisë. Kjo ka pasur ndikim për të kërkuar minoritete edhe atje ku ato nuk kanë ekzistuar.

Shekulli i XVIII është i njohur përgjithësisht si shekulli i zhvillimit të nacionalizmit modern. Midis kushteve për rritjen e tij më të rëndësishmet ishin: Centralizmi i avancuar, uniteti fetar, udhëheqja nga një klasë e vetëdijshme (aristokracia, borgjezia, inteligjencia), stimuli i jashtëm intelektual, pakënaqësia ndaj sundimit të huaj dhe uniteti gjuhësor. Shqipëria nuk kishte asnjërin prej këtyre parakushteve për zhvillimin e nacionalizmit modern në atë kohë.

Disa nga këto mungesa u kapërcyen me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit më 1878. Por më në fund ishte uniteti gjuhësor dhe ndjenja e të qenit një komb që çoi në kundërshtimin e pushtuesve sllavë e otomanë, të cilat themeluan unitetin kombëtar shqiptar.

Megjithëse opinioni publik në Greqi ka qenë i ndarë për kohën e përshtatshme dhe metodat me të cilat duhej realizuar Ideja Helenike, vetë Megali Ideja asnjëherë nuk është ndarë nga mendimi grek. “Grekun e ka ushqyer gjithmonë në zemër dhe e ka mbajtur gjallë atë, në qoftë se jo si mundësi praktike, të paktën si një dogmë të besimit të tij politik e fetar”. Kështu shprehej ish ambasadori amerikan në Greqi Tuckerman⁵. Ky mentalitet nationalist ka ushqyer përpjekjet e ethshme praktike për konservimin e zhvillimin e një identiteti helenik në popullsitë e krishtera ballkanike me origjinë jo greke. Ai do të bëhej kështu fusha kryesore e debatit dhe e ballafaqimeve midis grekëve dhe fqinjëve të tyre.

⁴ Peter F. Sugar, Ivo J. Lederer, *vep. e përm.*, f.36.

⁵ Charles K. Tuckerman, *The Greeks of Today*, New York: “G.P. Putman”, 1878, f.123-124.

Në fund të shekullit XIX, veçanërisht në Maqedoni, u zhvillua një betejë e fortë midis Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë për asimilimin e popullsisë vendase e cila ishte një përzierje turqish, shqiptarësh, hebrenjsh, grekësh, bullgarësh, serbësh e vllahësh. Kjo e komplikoi dhe e rëndoi më tej gjendjen e minoriteteve.

Serbia dhe Rumania propagandonin respektivisht për rigjallërimin e Patriarkanës Serbe dhe për krijimin e një Kise Rumune të pavarur në Maqedoni. Por Porta nuk mori ndonjë masë që të kënaqte këto kërkesa. Ndërsa Rusia në këtë kohë qëndronte indiferente kundrejt debateve midis serbëve e bullgarëve. Shkollat dhe kishat u bënë armët kryesore të propagandës politike. Fëmijët u bënë një komoditet i vlefshëm për të cilin agjitorët rivalë paguanin me kesh të fortë. Vëllezërit e një familje mësuan ta jepnin mbështetjen e tyre në mënyrë të barabartë midis propagandave rivale. Si rezultat u krijua një situatë absurde ku mund të gjeje tre vëllezër të një familje që propagandonin tre kombësi të ndryshme. Mund të jepen shembuj të shumtë kur njerëzit ndryshonin emrat nga vllahë në grekë, nga grekë në bullgarë dhe nga bullgarë në serbë dhe shumë prej këtyre kapotave të kthyer sërisht gjatë dimrit e kishin ndërruar prapashtesën serbe *-iç* me atë bullgare *-ov*. Ky çrregullim favorizohej fuqimisht nga Porta, e cila i transferonte favoret e saj në intervale jo të rregullta nga njëra racë tek tjetra, por që vijonte të vepronte sipas parimit “Divide et Impera”⁶. E gjithë kjo tablo mund të na japë një ide më të qartë të vështirësive që ka ndeshur procesi i ruajtjes dhe konsolidimit të identitetit të minoriteteve në Ballkan për arsye të karakteristikave të nacionalizmave ballkanike. dhe në përgjithësi të procesit historik të formimit të kombeve në Ballkan.

Mendimi shqiptar për minoritetet në etapën e parë të ekzistencës së shtetit të pavarur shqiptar

Mendimi i inteligjencies dhe personaliteteve politike shqiptare lidhur me minoritetet në Shqipëri është pasqyruar gjerësisht në faqet e shtypit shqiptar, në botimet apo pamfletet e ndryshme politike, në memorandumet dërguar institucioneve ndërkombëtare, etj. Pasqyrimi konkret dhe me tërë kolorin e tij për të gjithë periudhën e ekzistencës gati një shekullore të shtetit shqiptar nuk mund të bëhet në kornizën e këtij referimi, prandaj po mjaftohemi për ta trajtuar atë vetëm për periudhën 1912-1920.

Në momentet kur çështja shqiptare po diskutohej në Konferencën e Paqes, gazeta e shqiptarëve të Italisë, Kuvendi, nënvizonte edhe rëndësinë e përkushtimit të shqiptarëve ndaj mirëtrajtimit të minoriteteve. Ajo shkruante:

⁶ R.W. Seton-Watson, *The Rise of Nationality in the Balkans*, London: 1917, f.129-130.

“E pjekur nga vuajtjet e saj, Shqipëria, kur të ndërtohet, do t’ a ketë si detyrë të rrojë në bashkim të përkryer, me një frymë të gjerë durimi, duke u dhënë pakicave të huaja të gjitha të drejtat që ato i kanë gjetur në vendet e përparuara”⁷. Ndërsa, diplomati dhe patrioti i njohur Mehmet Konica, pasi vinte në dukje se Pindi banohej ekskluzivisht prej kuçovllehëve, të cilët ishin pasardhës të kolonistëve antikë romakë dhe blegtorë që vinin të dimëronin tufat e tyre të bagëtive në kullotat e Shqipërisë bregdetare, sugjeronte që ata duhej të zgjidhnin me vullnet të lirë nëse do të jetonin në përbërje të shtetit shqiptar apo të shtetit grek.⁸

Shembulli më i qartë i perceptimit pozitiv të qëndrimeve të nacionalizmit shqiptar kundrejt minoriteteve është kërkesa e vazhdueshme e popullsisë vllahe të Greqisë dhe Maqedonisë për të jetuar në suazat e shtetit të pavarur shqiptar. Kryetari i Dërgatës Shqiptare në Konferencën e Paqes së viteve 1919-1920 njoftoi Komitetin e të Dhjetëve për dëshirën që kishin shfaqur arumunët e Pindit për t’u bashkuar me Shqipërinë. Ndërsa Ministri i jashtëm Mehmet Konica deklaronte se “rumunët e Pindos, shumë krerë të të cilëve gjenden prej kohësh në tokën shqiptare, duan të shkundin zgjedhën greke e të bashkohen me Shqipërinë. Delegatë të zgjedhur prej këtij vendi do të shkojnë në Paris për t’ia paraqitur dëshirat e tyre Konferencës së Paqes, të kuturitur të mos u ndahen të drejtave të tyre, veçse me forcë. Ne e shohim vetëm me simpati këtë lëvizje, së cilës jemi gati t’i kushtojmë përkrahjen tonë të vërtetë e vëllazërore”⁹.

Qarqet diplomatike greke nxituan t’i përgënjeshtrojnë deklaratat e Ministrisë të Jashtëm Shqiptar, duke i cilësuar të pabazuara, pasi kuçovllehët që i kishin dhënë helenizimit burra si Averofi me shokë, nuk do të kërkonin shkëputjen nga Greqia mëmë e bashkimit e tyre me Shqipërinë.¹⁰

Mirëpo maqedo-rumunët që jetonin në Rumani i dërguan një memorandum Komitetit të të Dhjetëve, në të cilin kërkonin, në emër të të gjithë vllahëve, bashkimin e tyre me Shqipërinë e re. Gazeta Kuvendi e quante këtë memorandum “një titull nderi për kombin shqiptar”¹¹. Gazeta theksonte se e përkrahte çështjen e vllahëve jo pse ata kërkonin bashkimin me Shqipërinë, por sepse përpjekjet e tyre synojnë të sigurojnë qënien kombëtare, e ruajtur gjer më sot me të keq e me trimëri, por padyshim në rrezik që të humbasë në qoftë se popullit kuçovlleh Konferenca nuk do t’i plotësojë kërkesën e tij të shfaqur në Konferencën e Londrës të vitit 1913, dhe që përsëritet në memorandumin e

⁷ “Ekspozicioni i përshpagimeve shqiptare përpara Komitetit të të Dhjetëve”, *Kuvendi*, 16 prill 1919.

⁸ Mehmet Konica, “The Albanian Question”, *The Adriatic Review*, vol.I, n.4, Boston: dhjetor 1918.

⁹ “Kuvend’ i Paqes”, *Kuvendi*, 10 mars 1919.

¹⁰ *Po aty*.

¹¹ *Po aty*.

sotëm”¹². Kuvendi shkruante se çështja e rumunëve të Pindit nuk ndryshonte fare nga çështjet e tjera kombëtare të çdo populli që ishin shtruar para Konferencës së Paqes, e cila duhej t’i jepte asaj një zgjidhje në mënyrë që të mos shkelte parimet e saj të lirisë dhe të vetvendosjes. Ajo i paralajmëronte arumunët që të tregoheshin energjikë e të lëviznin, sepse ndryshe mundësitë e fitores së çështjes së tyre mund të pakësoheshin si rezultat i kundërshtimit dinak që, sigurisht, do t’i bënin grekët e serbët.

Kuvendi bënte thirrje për forcimin e solidaritetit dhe bashkëpunimit shqiptaro-vlleh. Shqiptarët dhe vllehët, për t’ia arritur qëllimit të shenjtë, lipsej t’i jepnin bashkëpunimit të tyre një fytyrë praktike e pozitive. Ajo u bënte thirrje edhe vllehëve të Amerikës, të cilët ishin të organizuar e mund të punonin lirisht, të ngrinin zërin e tyre në Paris, pasi ata, së bashku me shqiptarët e atjeshëm, mund t’i sillnin çështjes shumë shërbime të mëdha”¹³.

Kërkesa e vllehëve të Pindit për t’u bashkuar me Shqipërinë i shërbeu si një mbështetje morale, Delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes për të kundërshtuar politikën aneksioniste greke ndaj Shqipërisë së Jugut. Kryetari i Qeverisë shqiptare Turhan Pasha, në ekspozenë që i parashtrroi Konferencës për çështjen shqiptare, theksonte: “Ende vllehët e krishterë duan t’i bashkohen Shqipërisë. Në një kohë kur kundërshtarët tanë pretendojë se shqiptarët e Epirit të Veriut dëshërojnë të bashkohen me Greqinë, vllehët e Pindit, të cilët tashmë e kanë njohur mirë administratën greke, duan të bashkohen me Shqipërinë. Si është e mundur të pranojmë se ka shqiptarë të cilët duan të ndahen nga vëllezërit e tyre, kur një element i huaj, siç janë vllehët, që kanë jetuar nën rregjimin grek, kërkojnë të bashkohen me shqiptarët?”¹⁴ Kryeministri i Shqipërisë vinte në dukje se “Shqipëria, e pjekur nga vuajtjet e saj, kur të konstituohet si shtet, do të bëjë detyrën e saj që të jetojë në një bashkëjetesë perfekte me shpirtin e një tolerance të madhe, duke u garantuar minoriteteve të huaja të gjitha të drejtat që u janë njohur atyre në vendet më të zhvilluara të botës”¹⁵.

Gazeta kryesore e kohës, “Dielli”, e cila përfaqësonte pikëpamjet e organizatës më të fuqishme patriotike shqiptare, Federatës “Vatra”, e vlerësonte lart bashkëjetesën dhe trajtimin liberal të minoriteteve nga shqiptarët. Duke përshëndetur memorandumit e shoqërisë maqedo-rumune dërguar Konferencës së Paqes, gazeta shkruante se ai “ka një vlerë karakteristike për të drejtat që kërkojnë shqiptarët nga Konferenca e Paqes. Vëllezërit tanë vllëhë i ndihmojnë të drejtat tona me këtë veprim, gjë e cila do të bëjë një përshtypje të madhe në

¹² *Po aty*.

¹³ “Çështja e Vllehëve të Maqedonisë”, *Kuvendi*, 18 mars 1919.

¹⁴ Turhan Pasha, “The Expose of Albanian Demands Before the Peace Conference”, *The Adriatic Review*, prill 1919.

¹⁵ *Po aty*.

pjestarët e konferencës. Ajo i kalbëzon nga rrënja të gjitha shpifjet dhe kallëzimet serbo-greke, me qëllim që t'i diskreditojnë shqiptarët përpara opinionit publik të përbotshëm si të paqytetëruar". Më tej, thuhej se "Kucovllëhet e Manastirit dhe të Pindit, jo vetëm që kanë provuar vëllazërimin e tyre me shqiptarët, por do kenë lumturinë të gëzojnë gjithë liritë politike dhe njerëzore në shtetin shqiptar, sepse shqiptarët, si adhuronjës të lirisë, janë respektonjës edhe për lirinë e të tjerëve". Kërkesën e shoqërisë maqedo-rumune për t'u bashkuar me shtetin shqiptar, "Dielli" e cilësonte si "një provë të qartë, e cila tregonte se shqiptarët janë komb më i qytetëruar se serbët dhe grekët, të cilët përpiqen "të thëthinë elementët e ndryshme dhe të majmen me mishin e të tjerëve. Ndërsa shqiptarët dëshirojnë t'u japin lirinë çdo elementi që mbetet në pakicë në tokën shqiptare". Kështu, kufijtë, që kërkoi delegacioni Shqiptar në Konferencën e Paqes, ishin të drejtë, sepse pakicave rumune e bullgare që do të mbeteshin brenda tyre "ne jemi gati t'u japim çdo siguri për lirinë dhe zhvillimin e tyre kombëtar"¹⁶. Vllahët cilësoheshin si një element i dobishëm që kishin luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tregtisë gjatë periudhës osmane, të cilët me përvojën e tyre do të kontribuonin edhe për zhvillimin e tregtisë në shtetin e ri shqiptar. U kërkoheshin vllahëve në SHBA që ta mbështesnin memorandumun e shoqërisë maqedo-rumune dhe t'i dërgonin telegrame Konferencës së Paqes, duke kundërshtuar politikën e Venizellosit, i cili po përpiqej t'ua mohonte kombësinë e tyre. Madje, e njëjta gjë, u kërkoheshin edhe izraelitëve të Janinës dhe veçanërisht emigrantëve izraelitë të New Jorkut të cilët duhej t'i kërkonin Konferencës bashkimin me Shqipërinë¹⁷.

Në prag të Konferencës së Paqes edhe kleri i Kishës Ortodokse Shqiptare të Amerikës denoncoi politikën shtypëse të qeverisë greke kundrejt arumunëve të Pindit të cilët, qysh nga Konferenca e Londrës e vitit 1913, po u kërkonin Fuqive që të bashkoheshin me Shqipërinë, me qëllim që t'i shpëtonin keqtrajtimit dhe shtypjes greke¹⁸. Mendohej se kështu, do të vepronin edhe bullgarët e Maqedonisë Perendimore të cilët nuk do të hezitonin të integroheshin në Shqipëri, nëqoftëse atyre do t'u jepej si alternativë përfshirja në Greqi ose në Serbi¹⁹.

Ndërsa Sevasti Qiriazi dhe Dhimitër Bala, dy intelektualë dhe aktivistë të shquar të çështjes kombëtare shqiptare në SHBA, theksonin se "shëmbulli më i mirë që ilustron qëndrimin liberal të shqiptarëve kundrejt popujve fqinj, është besimi, që kanë treguar qysh në kohët e lashta vllahët, të cilët e shprehën

¹⁶ *Po aty.*

¹⁷ *Po aty.*

¹⁸ "Memorandum mbi Shqipërinë nga Kleri i Kishës Ortodokse Shqiptare të Amerikës, dërguar Presidentit Wilson", 27 nëntor 1918, *The Adriatic Review*, Vol.I, n.3, nëntor 1918.

¹⁹ *Po aty.*

besimin e tyre gjatë Konferencës së Londrës, së cilës i kërkuan që të jetonin në një shtet me shqiptarët”²⁰.

Shembullin e vllahëve do ta ndiqnin më vonë edhe bullgarofonët e zonës së Prespës të cilët duke e ndjerë së ekzistenca e tyre kombëtare po kërcënohej seriozisht nga përfshirja në shtetin grek ose atë serb kërkuan me forcë përfshirjen e tyre në shtetin shqiptar, duke e konsideruar këtë të vetmen garanci për ruajtjen e identitetit të tyre kombëtar dhe për respektimin e lirive të tyre politike, civile dhe kulturore.

Si përfundim do të theksonim se këta shembuj historikë dhe shumë të tjerë si këto tregojnë se, ndryshe nga nacionalizmat ballkanikë, nacionalizmi shqiptar kishte një fizionomi tjetër shumë më liberale dhe shumë më humane. Ky fenomen i pa studiuar meriton një studim shumë më të thellë në të ardhmen.

²⁰ Sevasti Dako, Dimitri Bala, “Albania’s Rights, Hopes and Aspirations”, *Yll’ i Mëngjezit* (The Morning Star) vol.3, N.7, Boston Mass.: nëntor 1918.